

Jeronim De Rada

BIBLIOTEKA
SHTETIT

214-1
214



**Krutan
i mërguar**

POEMË

SH-1

P/14

Jeronim De Rada

BIBLIOTEKA E SHKETTIT
 GJYRKASTER
 Nr. INV. ~~70737~~
 30158



Krutan i mërguar

POEMË

Shqipëruar nga ANDREA VARFI

KOMBINATI BOTUESI - SHKËRTORJA E B.

SHTËPIA BOTUESE «Naim Frashëri»

PARATHËNIE

Andrea Varfi, që ka merita për afrimin e De Radës me lexuesin tonë të sotëm, me shqipërimin e poemës «Krutan i mërguar» na shpie në gjurmët më të hershme të krijimtarisë së poetit, në mos po në më të herëshmen provë poetike të tij.

Poema «Krutan i mërguar», e shqipëruar sipas një dorëshkrimi italisht të vitit 1841, në të cilin titulli mungon, ka vlerë jo vetëm për të përvijuar sa më saktë historikun e krijimtarisë letrare të De Radës dhe për të depërtuar në zanafillën e në shprehjet më të lashta të saj. Ajo ka vlerë, ndonëse më të kufizuar e më të pacaktuar se veprat e tjera të poetit, edhe si një poemë në të cilën kanë gjetur mishërim ndjenja dhe aspirata kombëtare e njerëzore, që mund të ndikojnë edhe sot për edukimin patriotik të njerëzve dhe për të zgjuar tek ata ndjenja të çiltëra për atdheun, për të kaluarën e lavdishme, për kuptimin që merr ekzistenca njerëzore në luftë e në përpjekje për të

mirën e vendit e të njerëzimit, për fitoren e lirisë, të drejtësisë e të përparimit.

Në një formë jo aq të sigurt se në veprat e mëvonshme dhe nëpërmjet një kompleksi figurash në marrëdhënie të turbullta e të lëkundshme, ku shkrihen përfytyrimet reale jetësore në trajtë romantike, me vizionet fantastike naive të huajtura prej legjendave më të lashta dhe ecin përkrah i gjalli me të vdekurin, De Rada, në këtë poemë ka parashtruar, ndoshta për herë të parë (sidoqoftë më herët se tek «Këngët e Milosaut»), ato koncepte e pikëpamje shoqërore, politike e patriotike, që do të ndiqen prej tij në të gjithë veprimtarinë e gjerë patriotike, publicistike e letrare, duke marrë gjithnjë e më tepër forma më të përcaktuara, më të qarta e më të plota.

Sado që në një formë të mjegullt protoromantike, në këtë poemë, si dhe në veprat e mëvonshme të De Radës, bëhet fjalë për tragjedinë shqiptare të shekullit të pesëmbëdhjetë, për «rënien e mbretërisë shqiptare» pas vdekjes së Skënderbeut. Ky është fakti themelor historik që përbën tabanin e veprës dhe, mbi këtë taban, poeti është përpjekur të lidhë të kaluarën e madhërishe me gjendjen tragjike, dhëmbjen për vendin e pushtuar me brengat e me vuajtjet e mërgimit, etjen për lumturi personale me dëshirën për t'u sakrifikuar në emër të lirisë së atdheut, disfatën me brerjen e ndërëgjegjes për detyrën e pakryer e për dëmin e ambicjeve. Mbi këto baza, fantazia e

poetit ndërlidh Mirbanin e vdekur me Rrembhelmin e mërguar, që aspiron të kthehet në Shqipëri për të vazhduar luftën, jetën e të mërguarve arbëreshë me shpresën e çlirimit të atdheut, ashtu siç vihen në kontraste tronditëse e kaluara me gjendjen e kohës kur zhvillohen ngjarjet, aspiratat e bukura me realitetin e hidhur, dielli i lirisë e i drejtësisë me zotin, që «u bëhet krah armiqve dhe tiranëve», «shpirtmëdhenjve» të pavdekshëm dhe «shpirtkëllirëve», që edhe pas vdekjes lëshojnë mbi tokë hijen e pështirë të tradhtive e të poshtërsive të tyre. Përfytyrimi poetik i De Radës i shtrin krahët aq tepër, i ndikuar prej universalizmit të romantikëve, sa që luftën kundër robërisë, skllavërisë, tiranisë dhe padrejtësive e paraqet si një kundërveprim universal, real e ideal, të së mirës ndaj së keqes, të lirisë ndaj robërisë, të së drejtës ndaj padrejtësisë. Aty-këtu në vargjet e poemës duken shkëndijat e demokratizmit të mëvonshëm të poetit, sa herë ai flet me duf kundër pasnikëve e tiranëve dhe mban anën e «njerëzve të thjeshtë», të cilëve «u takon nderi, lavdia», se tek ata ai e mbështet më tepër shpresën e shpëtimit të atdheut

Edhe mendimi aktiv në poemë është më i turbullt e më i papërcaktuar se në veprat e mëvonshme, në të cilat megjithëse trajtohen tema të së kaluarës, nuk mungojnë as aluzionet e hapta për gjendjen e Shqipërisë në shekullin e 19-të. Por, sidoqoftë, vetë evokimi i epokës së Skënderbeut dhe i përgatitjeve për t'u he-

dhur në Shqipëri janë dy elemente mjaft më rëndësi, që do t'i kujtonin lexuesit të kohës se ajo detyrë ka mbetur pa u realizuar, po shpresat nuk kanë humbur që të përtërihet edhe një herë epopeja e lavdishme e shekullit të 15-të.

Shqipërimi që i ka bërë Andrea Varfi kësaj poeme, megjithëse i është larguar vargut njëmbëdhjetërrroksh të origjinalit, mendojmë, siç thotë edhe vetë shqipëruesi, se i përmbahet së tepërmi stilit të veprave shqip të De Radës dhe është bërë me vëmendje e kujdes të madh, duke përballuar vështirësi jo të pakta. Duke përshëndetur këtë punë me vlerë, le t'ia njohim si të drejtë përkthyesit shqipërimin e emrave të personazheve, ndarjen e poemës në katër këngë dhe datimin e tyre, sipas praktikës që ka ndjekur vetë De Rada në veprat e tjera.

RAZI BRAHIMI

N J Ë K U S H T I M

Edhe fjala nuk i shkoi,
e përbuzur, as u shua,
se Zeasit i pëlqeu,
si na thotë gojëdhëna,
të kujdesej dhe për dasmën
e hyjneshës s'ujrave;
s'heshti as buza e shpirtmëdhenjve
për vlerën e trimërive
të djaloshit Aqileht,
që i mban mend dhe i nderon
edhe sot gjithë një botë!

PINDARI — ODET ISTMIKE — VIII, str. 9

PROLOG

ODE ARBËRORE

Brigjet joniane të Kalabrisë, verë 1481

Kur mërgoi te lëtinjtë
trim Rrembhelmi i Udhiseut¹⁾
dhe i Praklenës, shtëpia
n'Arbër bëhej shkrumb nga zjarri;
tata, Atdheu i kishin rënë.
Zemra e tij ishte zymtuar,
ashtu siç është edhe nata;
por ajo nis t'i kthjellohet
nga dy sytë e Gjuhëmirës.

Pa një zog i bardhë, i bardhë,
posi bora e malit Pindit,²⁾
më iu sul mbi koka trimit;
e këtij nga përkrenarja
m'i rrëmben pendën e kaltër:

dhe rrëmbimthi fluturon drejt e te shtëpia e vashës, bijës së Perlat kreshnikut dhe të Mallmarës së mirë, e në prehër m'ia lëshon, teksa ajo, ulur te pragu shihte detin arbëresh.

Gjuhëmira: — Përse vallë, o zog i bardhë, po më sjell sot këtë pendë

nga ai vend ku unë linda, ku kam dhe të mi vëllezër, që ma mbanin përmbi kryet në Sfetigradin plot zulmë, ku dhe turka e mahnitur dilte të vështronte trimat?

Zog i bardhë, ç'më hap plagë dhe tani që e shkretë mbeta, edhe larg Atdheut tim?—

Zogu: — Vashë e mirë, gjuhëmirë, vish cilonën ngjyrëgjelbërt, çou shpejt e pastro odat, se të vjen dëshira jote, që aq shumë do të dojë, sa të donte edhe jot ëmë; që aq shumë do të mbrojë, sa edhe të tu vëllezër! —

Edhe vasha ashtu siç ishte, pa skemandilin në kryet,

shpejt m'u çua, e shpejt më rendi;
por, pa pritur hasi trimin,
edhe papritur ma puthi
duke qarë nga gëzimi.
Edhe përdoret ma mori,
e të dy më hynë brenda
në shtëpinë me tri qoshe,⁶⁾
që i kish ngritur Tatë-loshi.

KËNGA E PARË

Era brigjesh shkundte shkurret,
me të kuq ngjyer nga dielli
që nga mali i borës zbriste;¹⁾
dhe në rrugë, i përcëllonte
shqepzin borë përmbi zverk
vashës, q'ecte e menduar:
ndaj mbi brigjet e Agosë,²⁾
Rrembhelmi i Udhiseut
hapat ndali e mori frymë.
Vështroi qiellin e huaj,
që pa re pjerrej karpatesh
të përhirta, e rrëzë tyre
ai pa fshatra pamjevrazhda
dhe mbi shkëmb Furinë e re³⁾.
t'heshtur vrejti; e poshtë fushës
ai pa tufa që etjen çetnin
buzë Kratit kaltërosh,⁴⁾
që blerimit qetë shkrihet.

Por kjo ishte magji çasti
tek ky trim zemërfuri,
që me vetvete thotë:
Rrembhelmi: — Kjo pamje më të kuq ngjyer
zgjat një çast, siç zgjat të kuqtë
në fytyrë vashës sime,
gjuhëmirës zemërvrarë:
sheh ujdhezat e Hjeagut,⁵⁾
det e qiell, bimë e pproska,
dhe mahnitja e pushton:
por, sa nis lehtë një këngë,
sjell ndër mend mëmën Mallmarë,
edhe veten ngushëllon
me shpresën se s'do të shohë
zbehtësi n'odat e mia! —⁶⁾
Dhe shpejt bujarin shtegtar
e kaploi hidhërimi.
Pa xërmon për nga lind dielli,
e ndaj Jonit të veriut,
tej rrëpirës i ngul sytë.
Dhe nga dielli që zbriste
shëh si ndriste ujët **detit**,
sikur yjet me zhyt zbrisnin:
Një pikzore kaq të bukur
sa ta shihte do gëzohej
dhe malsori, por jo trimi,
se m'i kujtohet Atdheu,
prapë mëria ma **pushton**:

«Nxjerr tym Kruja përtej detit!»⁷⁾
thotë edhe ndër mend i vijnë
të bëmet, njerëzit e njohur,
zjarret, zemrat e dragojve,
ankthe lufte e të këqia.

«Memec është atjë dhe qielli,
dhe luginash lëngon bari
nuk ndjen gjë në varr dhe tata!»
Kujton trimi edhe vetveten,
përlotet dhe fshan «O tatë!»

N'atë det brengash dot s'gjen
fjalë t'ëmbël as për vashën;
fundi mynxyrë i Atdheut,
turma njerëzish përshkënditur,
napë vdekjeje m'i hedhin!

Ai xërmon, por, eh, nuk sheh
shpirtmëdhenj, mburrje për t'ardhmen!
Zemra i qan për ato kohë:
i tehr se as krojesh arbe
dot s'i shkon më vasha-nuse!

E te vendi i huaj, trimit,
tek kujton tatën e shkretë,
mendtë i merren, befas meket
dhe kërkon «një pikë ujë!»
Vasha-nuse e mban, dhe shfryn
ndaj vetë zotit shpirtkazëm:

Gjuhëmira: — Zot, kot quhe «i plotfuqishëm»,⁸⁾
kur rri sheh shtrojëpërgjakur

praqet tanë nën osmanët!
Vallë pse shkrepj prej qielli
agu i lirë, kur në tokë
do përplasej kjo mynxyrë? —

E dëgjon trimi dhe vrehet;
pa nga zemra i shfryn mëria
si një rreze zjarr e diellit
që zhurit edhe gris qiellin.
Atje lart i ngjan se sheh⁹)
përmbi fron zënien e jetës,
hije njerëzish vetëngjizur,
ngjitur nga botë të ndryshme;
shpirtmëdhenj, që radhas ndrisin
përballë planetit tyre
dhe të gjithë të bashkuar
nga një mall për gjithësinë,
brendë tokësore s'kanë.
Ndër ta, si shkëlqim hënor,
dhembje trimi vren Rrembhelmi
vetëm tek Mirban shpirtmadhi,
korrur në luftrat për Krujën!

Nga krejt ky vegim fantazëm,
para syve i mbeti trimit
shtati hie i Mirbanit
e me brengë po mendon:
Rrembhelmi: — Kush më sjell prapë ato ditë
kur i gjallë ishte Mirbani?
Me të merrte frymë Kruja,

ai m'ishte mburrje mëmash,
kur rrebesh mbi muret shfrynin
gjithë hordhitë e Ali khanit.
Sikur gjithë ajo lavdi,
aq fort mos kish ndezur flakën
e zilisë në gjoks tënd,
që edhe sytë m'i errësoi,
mbase dhe sot do shndrisnin
vatrat, nami arbëresh! —
Pa këtu kujtoi djaloshi
dhe një herë ato ditë,
kur la sallat mbretërore
edhe u derdh në sheshe luftrash,
ku na u duk se po përtërinte
lavditë e gjyshit të madh,¹⁰⁾
që pa ndihmë, e mposhti Azinë
edhe Evropën barklubi:
aq lavdi korri Rrembhelmi!
Por si korri kaq lavdi,
ky djalosh shpejt na kërkoi
të drejtonte edhe një sulm
nga fortesa mbi osmanët.
Po atë sulm n'ato ditë
dhe Mirbani e kish kërkuar,
e drejtimi i atij sulmi
domosdo iu dha Mirbanit,
pa Rrembhelmi u fye rëndë.

Por kur zbriti e teta mbremje

përmbi Krujën e rrethuar,
djaloshi Rrembhelm shikoi
brenda sallash mbretërore,
me habi, Mirbanin shtrirë.
Ky as qepallë s'lëvizte,
as ushqim në gojë s'vinte,
por rënkonte e gulçonte.
Dhë as mund ta ngushëllonte
as hojmjalta fjalë e Marës,
dashuria dhe kujdesjet,
ata sy aq vështrimkthjellët,
buzëqeshja e përmbajtur:

Të gjitha në zemrën plagë,
(nga tallazet e Atdheut),
nuk i linin asnjë tragë,
siç s'i lenë as retë hënës,
kur e vakët çan mes yjesh.

Por e keqja ndjell të keqen:
pas tri ditësh uri shtriga,
si prej zotit t'ishte yshtur,
nxin qytetin e rrethuar,
e mjaft trima ia heq luftës.
Edhe ajo shtrigë sodit
prej të ngrysurit pallat,
si gjithë ata trima Suli,¹¹⁾
që në ndihmë i vinin Krujës,
si në pritë turke u grinë.
Dhe të nëntët që shpëtuan

të plagosur, Ali khani¹²)
rob m'ia nisi zot sulltanit,
që sërish ai të m'i niste
Ali khanit dallgë-dallgë
hordhi të tjera për sulmin
kundër gjokseve të Krujës!

Olimpi gjëmoi, dhe gjëma¹³)
shkund me gurët, dhe Mirbanin...

Qetëj nata, e kur nga lindja
ndriste qiellit Parmenda,¹⁴)
e pendari dilte praktik
që pas vendit të Parmendës
të maste sa natë kishte,
Rrembhelmin, zemërndërkryer
nga betejat kryetrimash,
sapo e kishte mposhtur gjumi,
N'ato çaste krahun trimit
ia përkund një dorë aq lehtë,
sa iu duk si fryma e mëmës,
që po i thoshte: «Atdheu digjet!»
Shpejt ik gjumi e sytë hapen;
s'ishte mëma, por ish Mara,
nusja-vashëz e Mirbanit:
faqeskuqur, e përmbajtur,
që mezi frenonte vajin.
Qerpikët me lot përmytur,
shqepza flakur prapa krahësh,
n'atë natë ngjyrë argjenti.



ku përçark gjë s'pipëtinte,
si pa mend e lenë trimin...¹⁵⁾

II

Tek xërmon për nga lind dielli,
e ndaj Jonit të veriut¹⁶⁾
tej rrëpirës, i ka sytë,
i kujtohet tok me Krujën,
dhe kjo ngjarje, e mendon:
Rrembhelmi: — Sa zë t'ëmbël, kishe, o Marë!
Dhe ti, zot i qiellit, dije,¹⁷⁾
se nuk ka asgjë n'Atdhe,
që nuk është edhe ndër trimat!
Për kaq armiq që sot kemi,
dhe për gjakun që s'po derdhet
për Atdhe ashtu siç duhet,
dhe ti, zot, na je përgjegjës!
Të flas zhveshur: nuk jam vashë,
që kur bota i sterrosët
lutje e lavde s't'i kursen.
Mirban, eh, zjarr i pushtetshëm
të rrëmbëu larg qytetit:
gjak të merrje për suljotët,
por, shpirtmadh, t'ish kurmi i shkoqur;
edhe tek unë zilia...
Këtu heshti; kryet uli,

dhe në vaj na mbytet trimi.

E pa kujton i përmallshëm,

atë bisedë me Marën:

Rrembhelmi: — O ndër gratë, e para e Krujës,
të këqiat për Atdheun

dhe për ne, s'kanë të sosur! —

Mara: — O ti i biri i Prablënës,
zemra e Mirbanit nuk mposhtet,
por një parandjenjë e mjegullt
brenda zemrës po më thotë
se Mirbani s'do më kthehet! —

Sytë trimit iu përlotën:

Rrembhelmi: — Po bie Atdheu ynë!

Kundër ne kemi edhe zotin

e ndaj tij as lutjet s'vlejnë.

Por ti ndrojtje të mos keshë,

se Mirban fatosi s'është

një ndër prijësit e rëndomtë!

Në gjurmë të tij po nisem! —

Si t'ish yll Mara largohet
por gjithmonë i qëndron pranë.

KËNGA E DYTË

Sa mbaroi në shesh të luftës,
dhe si hija në mes lulësh
dritë-yjesh, iu ngjiti qiellit,
kujtimet, ankthe t'Atdheut,
që edhe i mposhtur, nuk po jepet,
zjarr Mirbanin prapë e ndezin
dhe vështrimin hedh mbi tokë.
Ai sheh arat, dhe sheh ujrat,
kallzit, pemët, shujtë njerëzish.
Brigjesh detesh sheh brezarë
të punuar, dhe mbi detet
një qilim diku të kaltër,
pa më thotë me vetvete:
Mirbani: — Dhe në klithma e në rrebeshe,
s'm'i vret sytë aspak kjo pamje.
Toka e qeshur, tek ju njerëzit
ushqen ndjenjat për gëzime:

mbi ç'është e mirë, njerëzore¹⁾
në të parët tanë, njerëzit
kthisin jetën, e kjo lidhje
dhe të vdekurit mban gjallë
e çdo tekje i bën varrin!
Andaj dhuna e një njeriut
përmbi njerëzit në botë,
kurdoherë kundërshtohet,
dhe kush vdes për këtë udhë,
nga çdo brez ai përlligjet.
Për këtë udhë, edhe unë,
o moj Mara ime e shtrenjtë,
ty të humba për gjithmonë;
ti do ngresh sytë e do qash;
do mejtosh n'aq fort të desha
gjersa prej teje u ndava!
Por të pakën, mos m'harro,
që ta ndjej grushtin armik
më të lehtë! Ah, kur dhe qielli
ndaj nesh m'i drejtë do shfaqet?
Eh, po shkrihet brezi ynë!..—

Ai fliste e andej nga lindja
po na i ndriste muzgu yjet
tek e tuk kupës qiellore:
lehtë plisave të blerët
shkonte lepuri kullotash;
e nga tymi mezi shquhej
edhe ajo shtëpi e shkretë

me tri qoshe, ku me punë
plak Perlati ngryste orët,
që kërkonte t'i mbaronin.

Një furi e papërmbajtur²)
i pushton gjoksin Mirbanit,
sepse e sheh si një grusht njerëzish
kurdoherë i zhytin turmat
thellë e më thellë n'humnerë
zgjedhe e prangash te kjo botë,
ku sulmohen natë e ditë
vetëm trimat që nuk shtrohen;
sepse sheh se si po struket
në një qoshe mirësia
qiellore, dhe për njerëzit
(kinse në emër të paqës!),
zi më zi po i shton mjerimet;
sepse sheh nëpër pallate
një kandil të zyrtë varur,
që po ndrit si kandil varri,
atë natë aq të rëndë
q'ë gëzojnë disa krimba
kot në salla katragjyshësh.
Dhe mëshirëploti zot
u qëndron atyre pranë,
dhe si dielli dëshmon,
kështu pranë u ka qëndruar!
E për ju, kroje, karpate,
gjuhë ati, Epëri,

gjëmoi qielli, e gjetkë u kthye!
Dhe tani: ne ndër të huaj,
të shpërndarë e po na treten
gjuha dhe cilësitë tona!
Mjerë ne! Të paatdhe,
rrojmë pa qëllim mbi tokë!
E pra, ne një kohë i patëm:
Atdhe, gjuhë, edhe cilësi!
Jeta vetë ishin për popull,
që, mejtimgrysur rënkon,
se s'mban mend lavdinë e parë,
gjaknë e zemrës arbëreshe.
Vallë ç'dëshirë e çon ndër male
shpirtin zjarr të Perlat trimit?³⁾
Atij gjë s'i mbet mbi tokë,
veç shtëpisë shkrumb në flakë.
Atje foshnjërinë e shkoi,
shijoi gazet, hidhërimet;
atje priti ai rreziqet,
ngadhënjeu, u rrit si prijës.
Në një breg lumi rreshtoi
burrat trima, e në betejë
ndrit mbi vdekjen, edhe frikën
zhduk nga gratë veshjekuqe.
Shkrepi agimi e fushës luftës,
mbi kalorësit kufoma,
hingëllinin tek-tuk kuaj
thundërkuq, ndën krifet brushë

sy përflaktë, e mbi breg tymi
dëshmon ndeshjen, e mbi kodrat
lufta zien, përqark ajri
të zë grykën e timba nxihet
prej një mjegulle beteje:
dhe Përlatin e pushton
gaz i fitores-habi.

Dibër, moj, pse turbullohe?
Nëntë ndeshje atij s'ia prekën
krenarinë e ngadhnjimitarit
dhe nuk është punë trimash
se kujt rrezet ia hedh qielli!

Por, eh, ra dhe Sfetigradi:
dhe pse e mbetur pa vendlindjen,
nusja e re, me burrin mundur,
as në vajet, zemërvrara
mallëkim kurrë s'lëshoi
ndaj Perlatit. Dhe në ditën
q'u mbajt zi për Sfetigradin,
te ballkoni prapë u shfaq
si të tjerat, e tronditur
nga kambanat tinguj zie.
Sytë e saj ishin siç është
dhembja në një zi të madhe:
Pranë trimit s'pa Rrembhelmin
që përpara si zorkadhi,
që ma ze dita në Fjerzë,⁴⁾
nuk i ndahej Gjuhëmirës,

vajzës mirë të Perlatit,
dritë jete e fatosit,
me ata sy aq vështrimëmbël,
rritur me djaln jetim,
tek kodra, tash mbetur shkretë,
vatrë e njëjtë e dy fëmijve,
mall i njëjtë për Perlatin,
që nga gazi fluturonte
kur i shihte kacavjerrur
në një trishkull të dy bashkë.
Sa kujton të dy fëmijët,
nis Perlati e qetësohet,
dhë Siç ishte, ai po kthehej.

Por Perlatit i kumtuan
se fajtor ai na qenkej
që ne humbëm Sfetigradin,
se «për mllef, thoshin, Perlati
s'paskej luftuar si duhej!»!

Edhe pse pa vend dënohet,
për Atdheun i rreh zemra:
në një vit ndërron tre vende,
me gjak lan sheshe betejash
që në veshë i ndjen përherë.
Por të ndyrët dhe trutharët
në shënjestrë atë e kanë
për një faj që s'i takonte!
Zemërplasar, shtrëngon dhëmbët:
prapë ndeshet dhe fiton;

e lavdi nuk mban për vete.
Pa Mallmara, e shoqja e shtrenjtë,
e dërrmuar nga kjo gjendje,
sytë i mbyll dhe e le vetëm
me të voglën Gjuhëmirë.
Për të s'ka më qetësi
edhe hidhet n'Hesperit.
Këtu i vjen edhe mandata
se «mbret Gjergji na la shkretë».
Pikëllimi e pushton,
se sheh fundin e Atdheut,
e me t'arbëreshë flet.
T'Arbëreshët: — Ti lot derdhe, O Perlat burri,
me ne brengët tona i qave;
ikja prej atdheut tënd,
për ty qe pelin, o trim!
Po ç'të bëjmë? Këtë fat
na paska caktuar qielli.
Ç'të bëjë i mjeri njeri? —

Dhe tani pa asnjë shpresë
dhe pa ditur ç'mund të bëjë,
shtrëgatën krenare e shkrin
në një shkretëtirë t'huaj.

KËNGA E TRETË

Dimri shkundi nëntë herë¹⁾
krahët borë t'Apeninit
përmbi degët gjetherëna:
dhe me diellin e vakët
shkoi mëllënja ndër ullishtet;
kurse bregut të një lumit,
një shtegtar që i paraprinte,
prej së largu sheh re pluhur,
dhe një turme i ndërron udhën.
Rrembhelmi: — Kreshniku tartar ua mbathi²⁾
me vrap këmbëvet ndaj detit,
duke lënë prapa frikën!
Andaj sonte edhe ti,
po më fryn qetë, moj erë,
sikur përkuqton lavditë.
Më mburo, ti vatrë e Krujë!³⁾
Eh, ç'më djeg malli i Atdheut!
Po dot s'kthehem, sepse gjetkë

po më pret detyrë e lartë! —

Tha dhe zemërhelm u nis,
e kaloi zallin e rrugës.

Syri i hënës n'armë i ndriste.

Ravgoi natën, gjithë ditën:

sa zbret muzgu me veriun,

që m'i zhvesh drurët e zverdhur,

trimi larg sheh një shkëmb shpellë

me një zjarr të madh përpara,

e rreth shumë t'armatosur.

Me ngurim e plot dyshime

për tek shpella ai niset.

Dhe kur zjarrit i shkon pranë,

sheh përtokë tek lëngojnë,

gjithë gjakra e duke u dredhur,

të plagosur pranë shokësh

dhe ndaj rrugës, e s'afrohet.

Atë mbrëmje atje pranë

mbi një timbë trimi ndalet:⁴⁾

atje na ishte një krua,

ku na rritej një ulli:

atje ndalej edhe vasha

ditën kur vinte për ujë.

Atje trimit i shkon mendja

dhe te lili i bardhë i nuses...

Por tani dhe bisku i lilit

i ngjan ngjyer me gjak t'arbër!

Pranë e ndarë në dy pjesë,

i del parzmore e Mirbanit:
dhe pendët e përkrenares
i përthyen, i dridh era
rrafsh me biskun, e mbi buzën
e përgjakur të parzmore...
Trimi psherëtin e thotë:

Rrembhelmi: — Eh, fatosi ynë i mjerë!

Vetëm një zot shpirtskëterrë
ty të mposhti e ç'mund të bëje
kur u derdhe për gjakmarrijen
e asganëve suljotë,
që të ligjtë i bënë copë?

Edhe jetën tënde e humbe!

Pa qepallën e përlotur,

mezi Rrembhelmi e mund:

por kujton gjithë sa heqin,

dhe të zbrazët ndien zemrën,

edhe pse në fusha lufte

dilte mundës, e i çante krahun

turk Ali khanit fodull.

E mbi timbë ku qe ulur,

atë mbrëmje edhe muzgu,

që nga kodrat me kaçuba,

tinguj të përzishëm fyejsh,

i përcillte, e iu kujtuan

me gërmadhat dhe heronjtë:

Por ato kohë më s'kthehen,

sepse edhe në tingujt ndien

stepje gishtash, tringe t'huaj,⁵⁾
që po prishin jonësinë.
Ndaj nga timba ku ish, çohet,
që të shkojë e ta pështyjë
atë mistrec që prish tingujt,
por ia mpin befaz mërinë
një si akull: kujton vlerat,
dhe të bëmet, por çap s'bën,
atë ças zemra s'përgjigjet:
zverdhet, mpaket dhe gulçon.
Dhe mbi gjymtyrët si akull,
bryma ulet, posi borë,
Pranë i shfaqet nj'udhëtar,
dhe pyet për Ali khanin
dhe për llahtarinë e grave.
Trimi hesht dhe ai thotë:
Udhëtari: — Vallë a mos shpirti për luftë
ty t'u mpi, sepse Atdheut
një fatos po i mungon?
Dhe ai, ndofta, për faj tënd!
Ai bëri, siç do bënte
gjyshi i madh, edhe pse fati⁶⁾
u tregua njerë me të!—
Po pa brengët e Rrembhelmit,
hije e Mirban udhëtarit,
pa përmallet, dhe shigjetat,
(shpërthim shqotash njerëzore),
i frethoi shpejt shpirtmadhi,⁷⁾

dhe ma ndjen si një vëlla,
sepse, (n'udhëtimin hije),
sapo qe kthyer nga Kruja,
ku kish parë odat e tij:
mbi shtrat: rrjeta merimangash,
vazot tharë e gjithë pluhur,
pranë vatrës; krejt të shuar,
shtrirë e shoqja, Mara e shtrenjtë;
prej pullazit ai me sy
kodra, miq kishte qafuar;
dhe përmallshëm, kishte thënë:
«Unë s'jam më në mes tuaj!»

E tani te dheu i huaj
sheh Rrembhelmin krejt të shkretë,
pa ma shtyn zjarr i Atdheut
t'i drejtohet edhe zotit:
Mirbani: — Me ngurim, zot, të drejtohem:
dikur, thonë, marrje pjesë
edhe në punët e tokës,
merrje pjesë edhe në ankthet,
doje edhe vatrën tona.
Dielli n'Arbër s'pa të lindin,
as të vdesin mëndjekotë,
që t'u shkojë e zbrazët jeta;
por atje dielli pa
vetëm vrulle të stuhishme
në krahirore të bashkuar.
Në një shekull atje ndritën

vepra që ndritin me shekuj!
Zot, mos vallë është e vërtetë
që tani je kundër nesh?
Dheut t'huaj, i panjohur,
trim Rrembhelmi i Udhiseut,
plot virtyte, nuk ka t'ardhme,
këtu s'ndien as dritën tënde.⁸⁾

Edhe fjalën e ndërpreu,
se një valë drite llapsi
(nga një kometë në qiell),
që na iu duk aq e ngrohët
sa dhe drita e diellit marsit,
që shkrin akujt e mbars lulet,
edhe nata erëvakët
më të ndritshëm i bën yjet.
Përmbi detet kreshpëruar
hije shpirtmëdhenjsh vallzojnë,
dhe nga pirlgu mëmë zonja
shikon manat dhe gëzohet.
Dhe hije e Mirbanit ngjitet
la më la kupës së qiellit.

KËNGA E KATËRT

Kundrejt Jonit n'Hesperi,
në një kodër Perlat plaku,
larg lumenjve stërgjyshore,
të veçuar ka shtëpinë,
por jo zemrën, që edhe ëndrrat
m'i sheh n'Arbër si gjithmonë.
Edhe e bija e Tatë loshit,
Gjuhëmira, me fëmijët
po në Arbër lot në ëndrrat
ato lodra aq të hijshme,
ndaj sa zgjuhet, m'i tret gazi.
Fat i madh për ato kodra
iù duk ardhja e Rrembhelmit,
bir miroshtit t'Udhiseut,
aq të shumë dëshiruar
nga plot vasha për kurorë.
Ç'ndiente vasha brenda zemrës,
djali, si t'i thosh një orë,
e kuptonte, e ulte sytë
zemërgaze e zemërdhembshun.
Hije e Mirbanit në qiell,¹⁾

edhe ngjyrën q'u jep dielli
cirkave kur bora shkrin
nga pullazet, e ve re,
andaj hap krahët vigane
e me gaz niset drejt tokës.
Posi një ujanë drite
përshkëndit hijet këllirë
të të gjithë të këqinjve,
(që sa gjallë ishin mbi tokë
në pelin na nxinë jetën:
kryeperlën e natyrës).
Ato këllira, ndër qiej,
të ndërkryera, pa shpresë,
enden duke nxjerrë klithma,
si mbi tokë nxjerrin bishët
ulërима e mjaullima
ndër net bore e thëllimi,
që kur nuset i dëgjojnë,
në shtrat ndiejnë rënqethje.

Hije e shpirtmadhit Mirban
çan mbi male, fusha, dete,
mbi katunde jetënxira,
dhe si ai që n'Atdhe kthehet
pas një rruge fort të gjatë,
dalngadalë zbret mbi tokë.
Dhe mbi kreshtën më të lartë
ulet ndënë qiell' e kaltër,
q'ish posi një fushë liri

nga puhi deti përkundur,
e lehtë i përzien lulet.
Dhe tek dera po ma rrihte
në fytyrë, si të gjallë
ndjeu veten, edhe zemra
nis t'i rrahë si mbi tokë:
në mes qiellit shikoi
një si diell që ngjall gurët
dhe blerimin jep ndër pyjet:
zjarrin e natyrës, diellin,
që me dashurinë e flaktë
vijon punën e lavdishme
me qëllim: Ditën e madhe: ²⁾
në mes tinguj të hareshëm
nis t'i endë vashës pajën,
mbrëmjes m'ia stolis me yje:
dhe për ditë huret e saj
po m'i rriten, siç m'i rritet
edhe i pastri zjarr i zemrës
kur më mban lulen e parë,
edhe sytë e flaktë iu hedh
pemëve dhe prozhmeve,
që së pastrës erë i qeshin.
Dhe tek trimi m'i shkon mendja,
pa më skuqet, m'i rreh zemra,
Ai zjarr aq ëndjemjaltë
ngjiz të bëmet edhe prehjet,
e me t'ëmbëlën dhe të thartën,

ankthin pendë e puthjen flakë,
q'edhe kur s'e nxjerr dot fjalën,
sytë e sjellja vetë flasin.

Kështu fshehtazi na zbriti
në mes njerëzish dashuria.
Pas një drithërimi t'ëmbël
depërton në jetën tonë,
përtërin, krijon familje
pa pushin, edhe përjetë.

Dashurinë e pa Mirbani,
dhe shkëlqeu nga gazmendi,
pa si shigjeta na çan
drejt nga Çiamisi, e qëndron³)
te një tumpull i rrëzuar,
përmbi barin që së lashtit
jeton rreth bedenave,
gërmadha të shekujve.
Atje gjet një qetësi,
si atë të netëve
kur s'fryn erë qiejve:
pa iu ngjall një mall i turbullt.
Ajo pamje pa lëvizje
i kujtoi në parzëm vdekjen,
e pa ndien tinguj varri,
por mejtimi i lartë i fshin:
thahet lulja, buçet bisku:
kështu vjen vdekja pas jetës,
dhe pas vdekjes na vjen jeta:

dashuria për të tjerët,
dhe për ne lind dashurinë. . .

Trimin nga këto mendime
e largon një llamburitje
që çan erën, si veriu
i çan retë majë kreshtash
dhe nis vallen fushash drita.
Pa Mirbani zemërdjegur
gjithë zjarr i thotë diellit:⁴⁾
Mirbani: — Ti që botës i sjell gaz
dhe shëndet e bukuri,
m'i dëgjo dhe këto fjalë:
Përmbi tokë i mbyllte sytë
një shpirtlartë, Udhiseu;
dhe sa rrojti paqe s'pati.
Ne pandehëm se ai paqen
do ta gjente tek i biri,
që ma duaj si dy sytë:
sot i shkretë në mërgim.
Dhe si nuse për të birin,
u mejtua për të bijën
e një prijësi të Atdheut,
edhe ky burrë i panjollë.
Të dy njëri-tjetrin duan.
M'i mburo, edhe m'i ngroh
ato dy zemra të reja! —

Këto tha dhe rrezet dielli
i drejtoi nga brigjet harca,

ku të rrallë lisa rriten,
dhe ku mbjell më pak zi fati.

E plot gaz Mirbani qan⁵)

gjithë mall vërtik drejt Krujës.

Dielli ndaj perëndimit

ia praron veshjen, e pamja,

me atë pah përmallimi,

si prej ajri hiri i jep,

nëpër ato re të kaltra,

të përndara poshtë rrëzash,

që vijon t'i çajë, e pret

të dëgjojë: e ja, dëgjon:

më të madhen drithmë jete!

Pranë, thjeshtësia e çiltër

me shkëlqimnë e saj e vesh,

posi vetë dashuria.

Dhe Mirbani, i mahnitur,

s'ia ndan sytë Krujës tij,

që me Arbërin, i duket

se si e donte përtërihej.

Pa i afrohet, e shpërthen:

Mirbani: — Përshëndetje, o Kruja ime,

dëshmi drite përmbi tokë,

vepër e njerëzve të thjeshtë,

q'u takon nderi, lavdia! —

Shpirtmëdhenjtë që lart shihnin

gjithë shend, edhe Mirbani

pas i ndjek qiellit të pastër.

SHËNIME

Kjo poemë e rinisë së poetit, e pabotuar gjer më sot, u gjet në shtatorin e vitit 1975 në fondin De Rada të «Bibliotekës qytetare» të Kozencës (Kalabri). Në dorëshkrim është pa titull, pasi mungon mbulesa. Ne, duke u mbështetur në përmbajtjen dhe në një shënjëzim në parathënien e botimit të parë (1836) të poemës «Këngë të Milosaut», ku shprehimisht flet për një poemë të rinisë së tij me titullin «Esule di Croja», i vumë po të njëjtin titull «Krutan i mërguar».

Dorëshkrimi në italisht, nga i cili u shqipërua kjo poemë, është i vitit 1841. Pasi fragmenti që riprodhon poeti në parathënien e poemës «Këngë të Milosaut», nuk haset në dorëshkrimin e 1841-së, ne mendojmë se gjatë viteve '30, kjo poemë duhet të jetë ripunuar prej poetit gjersa ka arritur në versionin e 1841-së.

Në origjinal poema ndahet në dy këngë; po këngën e dytë, e cila zë tri të katërtat e krejt poemës, e ndamë në tri këngë pasi vetë arkitektura e kërkonte një ndarje të tillë. Prologu, në dorëshkrim, është në prozë poetike.

Në dorëshkrimin italisht poema është në 11-rrokëshin e bardhë. Pasi në 8-rrokëshin karakteristik të De Radës jepej shumë më mirë ngjyrësia shqiptare dhe dilte më në pah stili poetik i autorit, ne e dhamë në këtë metër.

Gjithashtu, për të dalë më në pah ngjyrësia shqiptare, disa prej emrave të personazheve të poemës, (të ngjizur prej De Radës së ri me anë kompozitash në greqishte), ne i shqipëruam duke ruajtur kuptimin e përafërt të çdo emri kompozitë. Kështu, emrin «Nevralge» e dhamë me emrin «Rrembhelms», «Astoneme» e dhamë me «Praklëna», emrin «Eugloe» e dhamë me «Gjuhëmira», emrin «Erolave» e dhamë me «Mallmara». Emrin «Odise» e dhamë në trajtën që do ta jepte De Rada në Shqip «Udhise»; emrin «Morvan», (për të mos i kujtuar lexuesit emrin apo epitetin e përçmuar «mervan» = »i ndyrë», «i ulët», «i poshtër») i bëmë një ndryshim të vogël, duke i dhënë një emër shqip që pasqyron edhe vetë tiparet e këtij fatosi shpirtmadh, emrin «Mirban», (që bën mirë.)

Për ta dhënë sa më qartë, pa iu larguar ideve dhe figuracionit poetik të De Radës, nuk i kemi mbetur skllav ndërtimit shprehës eliptik dhe kemi bërë ndonjë shkurtim fare të vogël. Në të njëjtën kohë duke ndjekur vetë praktikën e mëvonshme të poetit, anash vargjeve kemi vënë emrin e personazhit që flet me të tjerët apo me vetveten, dhe në krye datën kur zhvillohen ngjarjet, ashtu siç e sugjeron vetë poema.

Në krye kemi citatin nga Pindari (Ode Istmike, str. 9). Këtë citat De Rada nuk e jep nga origjinali, po nga përkthimi në italisht i Borghit. Dy vargjet e para De Rada i zëvendëson me pika. Ne, për të dalë ideja më e qartë, i cituam duke u mbështetur në të njëjtin përkthim. Kjo ode kush-tuar Kleandrit të Egjinës, pas betejës së famshme të Salaminës, jemi të mendjes se u zgjodh si lajtmotiv nga De Rada, edhe si dëshmi e bindjeve të tij se edhe qëndrimi heroik i krutanëve në mbrojtje të Krujës, do të shënojë preludin e shpëtimit të afërt të krenjt Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë, ky citat, ku përmenden Zeasi (Zeusi),

hyjnesha e Ujërave (Teti, Deti), Aqilehti (Akili) u zgjodh nga De Rada edhe si dëshmi e bindjeve të tij se arbëreshët (shqiptarët), janë pasardhës të atij rodi pellazg e vigan që i dha lashtësisë, jo vetëm kryefatosat më të lavdishëm, si Aqilehtin me shokë, po edhe vetë perënditë e Olimpikut, si Zeasin me shokë. Pasardhës të tillë, që gjatë gjithë shekujve shkëlqyen, me Pirron, Aleksandrin, Skënderbeun me shokë, patjetër do të dalin fitimtarë, sepse në ndihmë të tyre një vazhdë të pasosur heroizmesh, pra në ndihmë të tyre kanë vetë perënditë e Olimpikut dhe gjithë shpirtmëdhenjtë e pavdekshëm, që si hije përjetë vigjëlojnë mbi qiellin shqiptar.

De Rada edhe si dëshmi e bindjeve të tij se arbëreshët (shqip-
tarët) janë pasardhës të tij, vëllëzë dhe bashkësi të tij.
Pastardhës të tij, që gjatë gjithë shekujve shkëlqyen,
me Pirron, Aleksandrin, Skënderbeun dhe shokë, patjetër du-
hej të dallim të këqinjve të tjerë që vaxhën të pa-
soni mendit dhe shpirtit të tyre. Në Olimp të Olimpit dhe gjithë arbëreshëve e pavarësisht që
si një përjetësi vëllëzë me djalë shqiptar.

PROLOG: - ODE ARBËRORE:

- 1) «*trim Rrembhelmi i Udhiseut*» = Ky djalosh trim, bir i kryefatosit dhe shokut të Skënderbeut, Udhiseut, të rënë në fushë të betejave antiosmane, për mbrojtjen e Atdheut, (ndofta protagonist i poemës omonime «Udhiseu» të të njëjtit autor), i mbetur jetim që fëmijë, të rritur në shtëpi të kryefatosit Perlat bashkë me të bijën e këtij Gjuhëmirën, pasi ka luftuar gjer në fund për mbrojtjen e Atdheut dhe të Krujës, detyrohet, si shumë të tjerë, të marrë rrugën e mërgimit në Itali, ku ndodhej edhe plaku Perlat me të bijën e tij.
- 2) «*posi bora e malit Pindit*» = Për De Radën, Pindi, Dodona, Molosia, Pelasgjia (Thesalia), Olimpi, si vatra pelazgësh, janë edhe vatra arbëreshësh.
- 3) «*në shtëpinë me tri qoshe*» = Tiparin triqoshësh kësaj shtëpie De Rada nëse nuk ia jep si simbol të një vatre konspiratorësh («trishja») ishte simbol i shoqërive sekrete revolucionare), këtë tipar mendojmë se ia jep kësaj shtëpie si shenjë dallimi si pikë drejtimi për arbëreshët e tjerë të sapovajtur nga Arbëri i pushtuar prej otomanëve.

KËNGA E PARË:

Rrembhelmi tok me vashën Gjuhëmirë herët në mëngjes po rendin drejt bregut jonian të Kalabrisë. Nga zhvillimi i ngjarjeve të mëvonshme të poemës, ky fillim i poemës të le të kuptosh se Rrembhelmi është në udhë për të zbarkuar në Shqipëri.

1) «që nga mali i borëm zbriste» = në tekst është «që nga Apenini i borëm zbriste». Për shkak ritmi dhe njëkohësisht për shkak se nga shënimi i vendit dhe i datës që kemi vënë në krye të «prologut» del qartë ku zhvillohet ngjarja, ne zëvendësuam emrin «Apenin» me emrin e përgjithshëm «mal».

2) «Përmbi brigjet e Agosë» = Në tekst emri «Agosë» është «Agaoa». Për t'i dhënë një ngjyrësi arbërore, ne i bëmë këtë ndryshim të vogël, pasi në arbërisht «ago-ja» do të thotë «ag-u», agimi. «Kur agoja është e vjen prej detit Jon», thotë Seremlja në një varg të tij. Si toponim nuk jemi të sigurtë në është i vërtetë apo i krijuar prej poetit.

3) «dhe mbi shkëmb Furinë e re» = Në tekst emri «Furia» jepet me F të madhe, pra, si emër i përveçëm, ndoshta sepse ka dashur t'i japë kuptimin e «tërbimit hakmarrës» të «Furie» (Erineve) të mitologjisë antike greko-romake, shpirti i të cilave tërheqej dhe vërsulej për hakmarrje vetëm për çështje të drejta. «Omnis furiis surrexit Etruria justis» (Gjithë Etruria u ngrit (më këmbë) e shtyrë nga furia (tërbimi) i drejtë) thoshte Virgjili. Nga një furi kësisoj, nga një shpirt hakmarrës i drejtë janë të ndezur bashkë me vashën edhe fshatrat arbëreshe, pra, gati të shpërthejnë kundër çdo zgjedhe.

4) «buzë Kratit kaltërosh» Lumi Krati, (Krathi i lashtësisë) për gjerësinë e luginës së tij është më i madhi në Kalabri.

5) «sheh ujdhezat e Hjeagut» = Në tekst emri «Hjeagu»

është «Eagii». Edhe emrit të kësaj ujdheze të detit Jon (që De Rada e nxjerr nga shqipja «i jonë»), për t'i dhënë një ngjyrësi arbërore, i bëme këtë ndryshim të vogël. Edhe për këtë toponim nuk jemi të sigurtë në është i vërtetë apo i krijuar prej poetit.

6) «*zbehtësi n'odat e mia* = Gjithë kjo tablo jep tërthorazi gjendjen psikike të Gjuhëmirës e cila, edhe pse arriti dëshirën e saj të madhe, (bashkimin me trimin e zemrës së saj), prapë e ndien se jeta e ngushtë, lumturia brenda mureve të shtëpisë së të shoqit, i duket e pakuptim, nëse nuk vihet edhe në shërbim të idealeve të mëdha patriotike, shoqërore, njerëzore.

7) «*nxjerr tym Kruja prej detit*» = Emri «Kruja» në tekst është «Kroja». De Rada edhe këtë toponim e nxjerr nga «krua». Po në këtë rrugë ecin edhe arbëreshë të tjerë.

8) «*Zot, kot quhe «i plotfuqishëm»*» Në poemë ndërhyrjet e vashës Gjuhëmirë janë fare të pakta; por edhe këto mjaftojnë për karakterizimin e saj si një shoqe të denjë për Rrembelmin; kjo nuk është e pajisur vetëm me bukurinë, fisnikërinë shpirtërore, por edhe me një dashuri aq të zjarrtë për atdheun dhe lirinë sa që rebelohet edhe kundrejt vetë zotit.

9) «*Atje lart i ngjan se sheh*» = Këtu kemi çastin-çelës (momentin kyç) të krejt poemës: kundër «besëlidhjes» së armiqve të Shqipërisë e të popullit shqiptar të bekuar prej vetë zotit të qiellit, poeti kundërve si bashkëluftëtarë të përjetshëm të Shqipërisë e të popullit shqiptar armatën e pasosur të heronjve të rënë në betejat shekullore për mbrojtjen e lirisë. Këta «shpirtmëdhenj» paraardhës të popullit tonë janë rreshtuar me gjithë shpirtmëdhenjtë e gjithë popujve të tjerë, nga dëshira e zjarrtë për të triumfuar e drejta dhe liria. Në mes të këtyre «shpirtmëdhenjve» të vdekur, De Radës, në vegimin e tij fantazmë, lart në qiell i ngjan se sheh «dhembje trimi» (dhembje trimi prej të gjalli) «vetëm tek shpirtmadh

Mirbani, korrur në luftrat për Krujën». Dhe këtu i përtërih si krejt e gjallë e kaluara: lavditë e Mirbanit, rënia e tij në betejë, ankthet e Marës, nuses-vashë të Mirbanit, brengat e vetë Rrembhelmit.

10) «*lavditë e gjyshit të madh*» = Lavditë e Skënderbeut.

11) «*se gjithë ata trima Suli*» = De Rada, duke përmendur ndihmën e shqiptarëve suljotë Krujës së shekullit 15-të, tërthorazi thekson edhe ndihmën që këta trima i dhanë, bashkë me arbëreshët e Greqisë, kryengritjes greke e gatishmërinë e tyre e të gjithë arbëreshëve, për t'i ardhur në ndihmë atdheut e popullit shqiptar në betejat e afërme për çlirimin nga zgjedha otomane. Nga grafia e emrit «Suli», të cilën De Rada e shkruan «Souli», kuptohet se në atë kohë poeti ynë duhet të jetë vënë në dijeni mbi të bëmat e Sulit përmjet burimesh frënge, kryesisht përmjet botimeve të Pukevillit të periudhës 1805-1820.

12) «*Ali khani*» = Kruja bie në duar të hordhive të Ahmet bej Evrenozit dhe të sulltan Mehmetit më 16 qershor 1476; pra, emrin Ali khan, që do të thotë «komandant Ali», De Rada këtu e përdor në kuptimin e përgjithshëm të komandantit armik.

13) «*Olimpi gjëmoi, e gjëma*» = De Rada përmend Olimpën; a) si malin ku kishin selinë perënditë e lashtësisë pelasgjike, pra, edhe shqiptare) b) gjeografikisht fusha poshtë Olimpit, quhej Pelazgji; po edhe emri i saj i mëvonshëm «Thesali» sipas De Radës shpjegohet me shqipen «te zalli»; c) për De Radën trevat që prej Nishit gjer në Gjirin e Artës në perëndim banoreshin në shumicën e tyre prej popullsisë shqiptare.

14) «*ndriste qiellit Parmenda*» = Hyllësi (konstelacion) yjesh, mbase hyllësia «Qerrja», që bujqve, pendarëve, barinjve u hyn në punë edhe për të kuptuar se sa orë natë ka akoma.

15) «*si pa mend e lenë trimin*»... = Pas këtij vargu De Rada

jep për analogji një skenë — ëndërr personale, të paraqitur me këto vargje: «si pat lënë edhe mua/ kur te kroi i Rrahëngjelit,/ ndaj të hirtit shkëmb me myshk,/ vashë e mohuar më shfaqej,/ me ata flokë të lëshuar,/ (por, eh, n'ëndërr, jo në zhgëndërr) /me cilonëzën përpara,/ të kthyer gjer përmbi gju,/ me kind mbërthyer për brezi,/ dhe të bortin shqepëz derdhur/ prej yjes së majtë e poshtë/ njësh me kofshën e me pulpën:/ dhe larg syve të të tjerve/ me trishtim më buzëqeshte/ teksa malevet agimi,/ shpërndante ditë të pastër,/ por në gjoksin tim gëzimi,/ tok me dyshimin më ndizej». Këtë skenë-ëndërr, të bukur në vetvete, ne e hoqëm nga teksti dhe e hodhëm këtu (në shënimet), pasi nuk shkon me atmosferën dramatike të skenës Marë-Rrembhelmi. Gjithash-tu De Rada në parathënien e botimit të parë të poemës «*Këngë të Milosaut*» na citon edhe një skenë tjetër në italisht, të nxjerrë nga «*Kënga e dytë*» e një versioni përpara 1836-ës të poemës «*Krutani i mërguar*», që në versionin e 1841-ës, që ne kemi në duar, De Rada e ka hequr. Për vlerën e saj në vetvete, edhe këtë po e japim të shqipëruar në vargjet tipike të De Radës: «*Unë edhe një herë u shtrija/ në shtratin tim, shkundur prej dadës/ së gëzuar, që isha kthyer./ Dhe nga korrjet vatrat qeshnin./ Në mejtime qiejsh kredhur,/ hëna ndriste, e dukej si ditë/ në lumenj rreth teje, o Makje;/ dhe zukatja e lehtë e bulkthit/ nëpër kallëz arat mbushte,/ edhe ajrin aq të qetë./ Vasha e lodhur, ende flinte:/ n'ëndërr po shikonte agun/ dhe shoqet tek mbushnin enët/ për korrtarët, e ajo për dore/ me të birin e bujarit/ rri te fundi terr i tremes./ Dhe pas pak, sapo të zgjohet,/ nga vatr' e tij, Zagarezit këtu mëndja do t'i vijë:/ dhe i magjepsur nga kjo natë/ këngëtare, do të kthehet,/ edhe sytë do t'i hedhë/ Makjes. tretur kodrash shtufi/ edhe pyjesh avulloshe:/ n'ato çaste jeta ime,/ hej, ç'më dukej e pasosur,/ si mbi tokë dashuria».*

16) «e ndaj Jonit të veriut» = Rrembhelmi, tok me Gjuhë-

mirën, si kemi thënë, është nisur nga vendbanimet arbëreshe në Kalabri në Jugëperëndim të Jonit drejt brigjeve verilindore të këtij deti, më të afërta dhe më të kundrejta me brigjet e atdheut, Shqipërisë.

17) «*Dhe ti, zot i qiellit, dije*» == Rrembhelmi, siç do ta thotë më poshtë poeti, përpara mynxyrave që ishin përplasur dhe përplasheshin mbi Arbërin dhe Krujën e tij, me zemrën plot helm e vrer, urrën jo vetëm miqtë e rremë evropianë e papën e me bekimet hipokrite apostolike po edhe vetë zotin.

KËNGA E DYTË

Pasi në fund të këngës së parë dëgjojmë premtimin e Rrembhelmit se po niset «në gjurmë» të Mirbanit (rënë në betejën për mbrojtjen e Krujës), De Rada përqëndron dritat e projektorit të tij poetik te figura e këtij kryefatosi. Dhe në këtë «shpirtmadh», këtë hero përjetësisht të pavdekshëm, e kemi të pranishëm, sikur të ishte i gjallë në mes të gjallëve gjer në fund të poemës, si kryeprotagonistin shpirtëror të saj, që ripërtërin të kaluarën.

1) «*mbi ç'është e mirë, njerëzore...*» = Mirbani, e tok me të De Rada, këtu dhe në vargjet para e pas, na jep kuintesencën e koncepteve filozofiko-shoqërore për vetë jetën njerëzore, koncepte shumë përparimtare për kohën.

2) «*Një furi e papërmbajtur*»... = Ana shoqërore e koncepteve të Mirbanit, e pra edhe të të riut De Radë, këtu e më poshtë shkon duke u theksuar: urrejtja për padrejtësitë konkretizohet me urrejtjen për vetë zotin e pallatet e sundimtarëve e të shtypësve, në dashuri për Arbërin e tij, për arbëreshët, të «shpërndarë ndër të huaj», ku edhe vetë gjuha e cilësitë kombëtare më të mira janë në rrezik «të tretën».

- 3) «*shpirtin zjarr të Perlat trimit*» = Mirbani (hije) që lart nga qielli, duke pasë si në pëllëmbë të dorës tokën e Arbërit dhe vendbanimet e arbëreshëve të shpërndarë brigjeve të Hesperisë (Italisë) jugore, dallon shtëpinë me tri qoshe të fatosit Perlat. Dhe këtu e në vargjet që pasojnë, ne njihemi së afërmi me jetën dhe të bëmet e këtij kryetrimi, me të shoqen besnike, Mallmarën, me vajzën-mirë(zanë), me jetimin e vogël, Rrembhelm, birin e Udhiseut e të Praklenës, që po rritej në shtëpi të Perlatit, tok me Gjuhëmirën e vogël.
- 4) «*që ma ze dita në Fjertzë*» = Në tekstin italisht fjala «Fjertzë» është «Felci», si emër i përveçëm, që do të thotë «fier». Pasi ngjarja zhvillohet në rrethet e Shqipërisë verilindore (Dibër, etj.) në vend të një emri të përveçëm, (toponimi) dibran të panjohur «Fier» e pamë të udhës të përdornim një toponim, tani shumë të nojhur po të atyre anëve, toponimin «Fjertzë». Krahasimi me sorkadhin këtu është për Rrembhelmin, i cili, siç e thekson në pak vargje-shtojcë poeti, që ne i kemi hedhur këtu, duke u besuar shpifjeve e intrigave të kurdisura kundër Perlatit, largohet prej shtëpisë së tij, duke ua bërë edhe më të rëndë dëshpërimin Perlatit dhe Mallmarës, që «*e dërrmuar nga kjo gjendje, / sytë i mbyll dhe e le vetëm / (Perlatin), / me të voglën Gjuhëmirë*». Dhe Perlati, pasi sheh se «*për të s'ka më qetësi.*» detyrohet të «*hidhet n'Hesperi*» (Itali). «*Këtu i vjen edhe mandata / se mbret Gjergji paska vdekur*».

KËNGA E TRETË

De Rada, pasi na njeh më së afërmi në këngën e dytë me jetën dhe të bëmet e Mirbanit e Përlatit, vazhdon të na njohë me Rrembhelmin në atdhe e në mërgim, duke na e

ballafaquar edhe me Mirbanin/ — hije pak kohë përpara se Rrëmbhelmi, i zbarkuar diku në Itali të ritakohej me Gjuhëmirën dhe të nisej; bashkë me të ose i përcjellë prej saj, që të bashkohej dhe të bëhej gati për zbarkimin në Shqipëri nën udhëheqjen e Gjin Kastriotit në verën e vitit 1481.

1) «*Dimri shkundi nëntë herë*» = Fjalët «nëntë herë» nuk duhet të merren në kuptimin «nëntë vjet» me radhë, po në kuptimin që edhe elementet e natyrës nuk mund ta durojnë që otomanët të arrinin të shtyheshin gjer në Otranto, andaj brenda dimërit 1480 pasi ra Otrantoja në duart e otomanëve, nëntë herë bora e mbuloi Apeninin. Themi kështu, sepse «fjalët nëntë herë», në kuptimin «nëntë vjet» nuk i përgjigjen as mërgimit të Perlatit, që bëhet përpara vdekjes së Skënderbeut (1468); as mërgimit të Rrëmbhelmit, që bëhet pas rënies së Krujës (1478); as rënies së Otrantos, që është e gushtit të 1480-ës.

2) «*Kreshniku tartar ua mbathi*» = Këto fjalë në gojë të Rrëmbhelmit dhe skena e shpellës me luftëtarë të plagosur që vjen më pas, na tregojnë tërthorazi se jemi pas betejës për çlirimin e Otrantos dhe dëbimin e otomanëve nga brigjet italiane, që ndodhi në vitin 1481 dhe ku, si mund të merret me mend, duhet të ketë marrë pjesë edhe Rrëmbhelmi e arbëreshë të tjerë.

3) «*më mburo ti vatrë e Krujës*» = Rrëmbhelmi dëbimin e «kreshnikut, khanit, komandantit tartar dhe hordhive të tij nga Otrantoja e vlerëson si preludin e dëbimit të barbarëve otomanë edhe nga Shqipëria e Ballkani, që është i mendjes se do të bëhet me anë të kryengritjeve zinxhir të popujve të shtypur, të ndihmuar edhe nga popujt e tjerë të Evropës. Rrëmbhelmi, «i djegur nga malli për Atdhe» do të dëshiron të kthehej menjëherë në Shqipëri, mirëpo hëpërhë nuk mundet, se e «pret detyrë e lartë»: (përgatitjet për zbarkim nën udhëheqje të Gjon Kastriotit), andaj, i përmalluar, i

drejtohet erës duke i thënë: «më mburo ti vatrë e Krujë!»

4) «*mbi një timbë trimi ndalet*» = Rrembhelmi, i lodhur nga udha ndalet të pushojë mbi një timbë (shkëmb) pranë një kroi, atje ku ndalet dhe vasha ditën kur vinte për të marrë ujë. Mendja i shkon te martesë dhe, ndërsa lodhja e gjumi e marrakotin, përpara i del «*lili i bardhë i nuses*» me biskun të ngjyer «*me gjak t'arbër*»; pranë, «*e ndarë në dy pjesë/ i del parzmorja e Mirbanit*». pastaj i del një udhëtar, që është vetë hieja e Mirbanit në gjithë skenat gjer në fund të kësaj kënge.

5) «*stepje gishtash, tringe t'huaj*» = Për De Radën, kusht themelor për mbajtjen gjallë të «shqipëtarizmit» në gjithë shqiptarët e mërgimit, tok me mjeshtërinë e përsosur në ekzekutim, është edhe ruajtja e zhvillimi i mëtejshëm i karakterit kombëtar të çdo manifestimi kulturor-artistik të trashëgimisë (traditave), pra, edhe të këngëve, të muzikës; andaj, asnjë tringë (tingull) të huaj nuk duhet qasur në këngët dhe muzikën tonë, sepse prishin jonësinë (melodinë) kombëtare.

6) «*Gjyshi i madh...*» = «Ai fatos (Mirbani), që «*ndofta për fajin tënd*», o Rrembhelm, i mungoi Atdheut, bëri, ashtu siç do të bënte Skënderbeu». Këto fjalë të udhëtarit (që është vetë Mirbani) janë thika më e rëndë për ndërgjegjen e djaloshit, i cili vazhdon ta ndiejë thellë brengën që dikur, në të ritë e tij, nga zilia, nuk i shkoi në ndihmë Mirbanit (Kujtoni, këngën e parë).

7) «*dhe shigjetat... i frethoi*» = Mirbani pendohet në ças për goditjen që i bën djaloshit, dhe menjëherë ndien një dashuri të fortë prej vëllai për Rrembhelmin, sepse edhe tek ai e sheh të zjarrtë dashurinë për Atdheun; pra sheh vazhdimësinë e luftës për çlirim.

8) «*këtu s'ndjen as dritën tënde*» = Mirbani, pasi përballon (sfidon) zotin duke iu kundërvënë me simbolin e dritës së

përjetshme, Diellin, si dëshmitar të lavdive arbëreshe, edhe një herë e lut, po edhe e kanos, që të tregohet mirëdashës të paktën ndaj breznive të reja shqiptare, të përfaqësuara nga Rrembhelmi, se po të mos tregohet i tillë do të ketë si përgjigje të merituar: përbuzjen dhe urrejtjen e tyre.

KËNGA E KATËRT:

Ribashkimi i çiftit Rrembhelm-Gjuhëmirë është gaz i madh jo vetëm për këta të dy e për Perlat plakun, po edhe për gjithë arbëreshët e Kalabrisë. Te ky bashkim të gjithë shikojnë preludin e bashkimit të të gjithë arbëreshëve dhe çlirimin e Atdheut nga zgjedha otomane.

I. «*Hije e Mirbanit në qiell*» = Për De Radën lufta për çlirimin e popullit shqiptar dhe të popujve të tokës nuk është një luftë e kufizuar, po një luftë revolucionare me përpjesëtime vigane, që zhvillohet anembanë gjithësisë, në qiell e në tokë, sepse është luftë në mes dritës dhe errësirës, në mes drejtësisë dhe tiranisë. Dhe në një luftë të tillë askush nuk mund të qëndrojë soditës i thjeshtë. Tok me masat e shtypura nga tirania e shtypësve dhe të mbajtura në errësi-sirë, rreshtohen në ballë të tyre si flamuj kushttrimi gjithë hijet e të rënëve për idealet më të larta të njerëzimit.

2) «*me qëllim: Ditën e madhe:*» = Për Mirbanin, dhe gjithë «shpirtmëdhenjtë» «hijet këllirë» duhen shfarosur edhe në qiell, që mbi tokë e kudo të ndihet dhe të ndritë sa më e fortë drita, e trupëzuar (personifikuar) nga «*zjarri i natyrës, Dielli*», i cili «*vijon punën e lavdishme/ me qëllim: Ditën e madhe:*» lamturinë e jetës njerëzore, lumturinë e njerëzve.

3) «*drejt nga Çiamisi, e qëndron:*» = Çjamisi (lumi i Çamërisë, «Thyamisi»), që De Rada i ri e italizon në «*Tamigi*».

4) «gjithë zjarr i thotë diellit», = Mirbani, edhe pasi nga dashuria e zjarrtë për Rrembhelmin e Gjuhëmirën, që dëshironte t'i shikonte të bashkuar, e kishte detyruar veten t'i lutej edhe vetë zotit të qiellit që t'u bëhej krahë këtyre dy të rinjve, prapë nuk është i sigurtë plotësisht se zoti, që mbron të këqinjët e shpirtkëllirët, ka për t'u ndihmuar, andaj ky i drejtohet diellit, trupëzimit (personifikimit) të dritës, atij që «botës i sjell gaz/ dhe shëndet e bukuri». Dhe dielli përnjëherësh rrezet e tij «i drejtoi nga brigjet harca./ku të rrallë lisa rriten,/ dhe ku mbjell me pak zi fati», nga viset malore si qendra të arbëreshëve dhe të patriotizmit shqiptar.

5) «E plot gaz Mirbani çan»: = Mirbani, i kënaqur çan drejt Krujës së tij e dielli ndaj perëndimit «ia praron veshjen» e ai pret të dëgjojë «më të madhen drithmë jete»: shpërthimin e kryengritjes në kryeqytet, dhe në krejt Arbërin: çlirimin e shëh të sigurtë, sepse shikon të ngritur në luftë gjithë «njerëzit e thjeshtë» «q'u takon nderi, lavdia», vepër e të cilëve është edhe vetë Kruja e tij, kjo «dëshmi drite përmbi tokë».

A. VARFI.